




REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prijmjen / Prudatu Received / Delivery	14. 05 / 2021	viti god year	1
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHCK	2399/2021		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.267/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-Kryetare e Kolegjit, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtar dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.267/2021 të datës 12.04.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë rruga "Muharrem Fejza", hyrja 15/12, kati VI, nr.27, Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Universiteti i Prishtinës, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 12.05.2021, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Shpallet jo kompetent për të vendosur për ankesën me numër A.nr.267/2021 të datës 12.04.2021, të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit i punësuar në Universitetin e Prishtinës, në pozitën "Drejtor i Prokurimit", sipas akt emërimit të datës 14.09.2012, me numër Ref.nr.2/530, me datën 08.11.2021, Sekretari i Përgjithshëm i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", ka nxjerrë vendimin me numër Nr.Prot:11, me të cilin i ka shqiptuar ankuesit masën disiplinore "Suspendim i përkohshëm nga puna" me 50% të pagës bazë, për periudhën jo më shumë se tre (3) muaj.

I pakënaqur me vendimin e Sekretarit të Përgjithshëm të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", për suspendim të përkohshëm nga puna, ankuesi me datën 25.01.2021, ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 791 në Inspektoratin e Punës të Ministrisë së



Punës dhe Mirëqenies Sociale. Inspektorati i Punës ne kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, me datën 29.03.2021, ka nxjerr vendimin me numër Nr.01/12-116/20, sipas të cilit e "ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pabazuar për shkak të jo kompetencës".

Kundër vendimit me numër Nr.Prot:11 te datës 08.01.2021, të Sekretarit të Përgjithshëm të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", ankuesi me datën 12.04.2021, ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 1708/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil tw Kosovës, me pretendimet ankimore për: zbatim tw gabuar tw sw drejtës materiale, vërtetim tw gabuar dhe jo të plote të gjendjes faktike, shkeljes sw parimit tw ligjshmërisë dhe shkeljes sw parimit të sundimit të ligjit i garantuar me nenin 3 dhe 7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 12.04.2021 me Nr.Prot:1708/2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendim me numër Nr.01/12-116/20, i datës 29.03.2021 i Inspektoratit të Punës; Akt emërim i ankuesit me numër Ref.nr.2/530 i datës 14.09.2012; Vendim i datës 29.03.2021, me numër Nr.01/12-116/20 i Sekretarit të Përgjithshëm të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina"; Shkresë zyrtare e datës 17.12.2020; Kërkesë për interpretim ligjor e datës 21.09.2020; Kërkesë për interpretim ligjor e datës 23.10.2020; E-maili zyrtar i datës 28.12.2020; E-maili zyrtar i datës 23.12.2020; Letër standarde për tenderuesin e eliminuar; Vendim i datës 24.12.2020 i Drejtorit të Zyrës së Prokurimit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina"; Urdhëresë e datës 13.11.2020; Urdhëresë e datës 28.12.2020 ; Vendim i datës 10.02.2021; Raporti vjetor për kontratat e nënshkruara publike për vitin 2020; Raporti vjetor për kontratat e nënshkruara publike për vitin 2019.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar dëshmitë e ofruara nga palet, ka konstatuar se: sipas Ligjit, Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht nenit 2 paragrafit 4 përcaktohet se: *4. Nëpunës i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike*", dhe si rrjedhojë ka konstatuar se zyrtarët publik të nivelit të lartë drejtues, profesional dhe shërbimeve të brendshme në kuadër të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë në Kosovë, respektivisht në Universitetet Publike, kanë statusin e nëpunësit të shërbimit publik. Andaj, duke marrë parasysh se ankuesi tanimë me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë i përket kategorisë së nëpunësve të *Shërbimit Publik*, Kolegji vlerëson se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur për nëpunësit me status të shërbimit publik.

Bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli është kompetent për të vendosur vetëm



për nëpunësit civil dhe kandidatët për pranim në Shërbimin civil, siç është përcaktuar në nenin 2 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 dhe paragrafi 3 si dhe nenin 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas konstatimit se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e ankuesit, e udhëzon palën në rastin konkret ankuesin për ushtrimin e mjeteve juridike bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 74 si dhe nenin 24 paragrafi 4 ku përcaktohet se: *"Nëpunësi i Shërbimit Publik dhe nëpunësi administrativ dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente"*.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.267/2021

Ardita Perçuku-Shyti

Procesmbajtëse



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Universitetit të Prishtinës ;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Universitetin e Prishtinës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.